



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31154-01050-80-2020 **Data e Regjistrimit :** 24/02/2020
Numri i Vendimit: 80-2020-1461 **Data e Vendimit :** 10/07/2020

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 10/07/2020mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites {...}, i biri i dhe i , i datelindjes 04/07/1982 I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale -(DPPI)

Objekti:Shfuqizimi i aktit administrate, vendimit Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale dhe vendimit Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 i Bordit te Apelimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me ane te se cilit eshte vendosur: "Shfuqizimi i markes me emertim "{...} ...{...}", me nr.regj. 18149" ne pronesi te pales Paditese.

Baza Ligjore:Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" (Ne vijim referuar: "Ligji 49/2012"); Nenet 94 pika dh, 141, 143/3/a), 173 dhe 184/? te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar, (Ne vijim referuar: "Ligji per PI"); Kreu VI i VKM Nr. 1706, date 29.12.2008, "Per Miratimin e Rregullores per Regjistrimin e Markave Tregtare dhe te Sherbimit" (ne vijim "Rregullorja");

Paditesi {...} nepermjet perfaqesuesit Av. {...}:

Pranimin e kerkesepadise.

Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale nepermjet perfaqesuesit Z. {...}:

Rrezimin e kerkesepadise.

Personi i trete {...} nepermjet perfaqesuesit Av. {...}:

Rrezimin e kerkesepadise.

VEREN :

Paditesi {...}, i është drejtuar me kërkesepadi Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, duke kerkuar sipas objektit. Gjykata, referuar objektit dhe shkakut ligjor te padise, ne mbeshtetje te nenit 7, germa "a" 10/1, dhe 11/1 te ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" i ndryshuar, dhe nenit 36 te Kodit te Procedures Civile, kryesisht konstaton se eshte kompetente nga pikepamja lendore dhe tokesore per gjykimin e kesaj geshjte dhe se mosmarreveshja ne fjale ben pjese ne juridiksionin gjyqesor.

Per te bere te mundur mbrojtjen dhe perfaqesimin e interesave te shtetit ne kete gjykim, ne zbatim te nenin 79/a te K.Pr.Civile, kerkesepadia dhe aktet i'u njoftuan Avokatures se Shtetit, Zyra Vendore Tirane, e cila ndonese rezulton te jete njoftuar rregullisht per gdo seance, pa ndonje shkak te arsyeshem nuk u paraqit.

•€€€€€€€ Rrethanat e geshjtjes:

Paditesi {...} eshte pronar i markes fjale dhe figure me emrin "{...}{...}{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149, per klasen klases 43 te klasifikimit te Nises, "Sherbime bari; sherbime kafeneje; sherbime kafeterie; sherbime furnizimi ushqimi dhe pijesh, catering; sherbime restoranti; sherbime restoranti me vetesherbim".

Kunder kesaj marke, ne daten 20.12.2018 eshte paraqitur prane Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, nga z. {...} (person i trete ne kete gjykim), kerkesa per shfuqizim, me pretendimin se marka shkel te drejtat e meparshme te emrit te tij tregtar, duke e mbeshtetur pretendimin e tij ne parashikimin e nenit 143 dhe 173 te Ligjit Nr .9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar.

Me vendimin Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 Dhoma per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka vendosur: "Shfuqizimin e markes me emertim "{...}{...}{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149.

Kunder ketij vendimi, paditesi Eduan Baholli i eshte drejtuar me ankim administrativ Bordit te Apelimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Ky i fundit pasi ka shqyrtuar ankimin administrativ te paraqitur nga paditesi, ne perfundim me vendimin Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 ka vendosur: "Rrezimin e kerkeses per apelimin e aktit Nr. 311/11 date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim."

Duke mos qene dakord me vendimmarrjen e pales se paditur, paditesi i eshte drejtuar gjykates me kerkesepadi duke kerkuar sipas objektit.

•€€€€€€€ Pretendimet e paleve:

Paditesi:

Nepermjet parashtrimeve te pasqyruara ne kerkesepadine e paraqitur per gjykim si dhe ato te paraqitura gjate gjykimit, nga pala paditese ne menyre te permbledhur eshte pretenduar si me poshte:

1. Emri tregtar i pretenduar nga paditesi nuk eshte me ne perdorim ne treg nga kjo pale. Sig mund te shihet nga ekstrakti i QKB personi fizik qe pretendon se ka te drejtat ne fjale eshte me aktivitet te pezulluar dhe kjo do te thote se ai nuk ushtron me aktivitet tregtar. Sqarojme se emri tregtar eshte nje emertim i nje subjekti tregtar qe ushtron aktivitet tregtar. Vetem regjistrimi ne nje moment te caktuar ne QKB, nuk konsiderohet si emertim tregtar ne kuptimin qe te terheqe te drejten per te kerkuar mbrojtje nga Ligji 9974. Kjo jepet jo vetem nga neni 5 i Ligjit 9901/2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, por edhe nga vete neni 143/3/a i Ligjit 9974, i cili thote se: "3. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si: a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet". Ne rastin konkret, personi i trete nuk prodhon apo siguron mallra apo sherbime te njejta apo te ngjashme me ato te titullarit te markes 18149, pasi ky subjekt, nuk ushtron me aktivitet tregtar me kete emer.

2. Fakti i mesiperme rezulton edhe nga fakti tjeter, qe aktualisht ne perdorim te kesaj shenje dalluese eshte nje tjeter subjekt juridik, shoqeria "{...}" sh.p.k., e regjistruar ne 04.07.2018, pra shume kohe pas regjistrimit te markes nga ana e paditesit. Pra, nuk mund te kete emer tregtar, pa qene tregtar dhe personi i trete nuk eshte tregtar. Ne rastin konkret, jemi perpara faktit qe te drejten e meparshme te emrit tregtar e ka paditesi dhe jo personi i trete. Sqarojme se marka 18149, eshte perdorur nga paditesi si emer tregtar, shume kohe perpara depozitimit te kerkeses per regjistrim marke. Ky emer tregtar eshte perdorur qe ne vitin 2012, fakt qe provohet jo vetem nga fotografite qe i jane bere ambienteve tregtare (restorantit) ku ushtron aktivitet titullari i markes 18149 (fillimisht shtetasi Altin Vergani, dhe pas transferimit te aktivitetit, nga paditesi), permes postimeve ne rrjetet sociale ne vitet 2012 e vijues, por edhe nga kuponet/faturat tatimore, si dhe nga dokumentacioni zyrtar qe paditesi disponon nga kontrollat e bera nder vite nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit, ku eshte reflektuar emertimi tregtar {...}.

3. Te dy faktet e mesiperme edhe pse ia kemi parashtruar si Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim, ashtu edhe ne ankimin drejtuar Bordit te Apelimeve prane DPPI, shihet qe nuk analizohen prej tyre ne vendimet reciproke. Ne kete menyre, eshte cenuar standardi i arsyesimit te vendimit te dhene nga nje organ publik. Nese do te kishte analizuar drejte faktet e mesiperme, pala e paditur do te kishte dale ne nje perfundim te ndryshem.

Pala e paditur dhe Personi i Trete:

Nepermjet prapesimeve te paraqitura gjate gjykimit, pala e paditur DPPI dhe personi i trete {...}, ne menyre te permbledhur prapesuan kerkimet e paditesit si me poshte:

Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale:

1 Sipas nenit 143 pika 3 te ligjit nr. 9947/2008, Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si: a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet; Referuar dispozites se sipercituar, qe te provohet pretendimi i kerkuesit duhet te plotesohen kushtet kumulative si vijon: a) Qe kerkuesi mbi shenjen e tij te gezoje te drejta nga nje date me e hershme se sa data e aplikimit te markes qe kerkohet te shfuqizohet. B) Qe emri tregtar ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te shfuqizohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te shfuqizohet.

2. Kerkuesi (personi i trete ne kete proces) eshte tregtar i regjistruar, ne kuptim te pikes 1, te nenit 2, te ligjit nr. 9901, date 14.04.2007 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"i ndryshuar. Kerkuesi eshte mbajtes i se drejtes mbi emrin "{...}" te regjistruar prej dates 09.02.2017, te vertetuar nga ekstrakti i QKB. Nese kjo e dhene, do te ishte shtuar me vone se data e regjistrimit fillestar, sig dyshon pronari i markes qe kerkohet te shfuqizohet (paditesi), kjo do te ishte pasqyruar ne ekstraktin historik te subjektit tregtar. Personi i trete (kerkuesi ne procesin administrativ), ka si fushe te veprimtarise ofrimin e sherbimeve te barit e restorantit. Data 09.02.2017, e regjistrimit te kerkuesit si subjekt tregtar ne QKB, eshte me e hershme se sa data 27.03.2017 e aplikimit te markes me emertim "{...} ...{...}", me nr. regj. 18149. Emri "{...}", ne kuptim te VKM nr. 537, date 01.08.2007 Per rregullat per emrat dhe emertimet tregtare" eshte emertimi tregtar i personit fizik te regjistruar ne regjistrin tregtar prane QKR-se, (sipas kerkesave te

nenit 9, te ligjit nr. 7632, date 4.11.1992), qe perdoret prej tij ne kursin e tregut, i njoftuar vullnetarisht, ne perputhje me shkronjen "a" te pikes 1 te nenit 44 te ligjit per QKR-ne. Si i tille, ky emertim ka si qellim identifikimin e origjines se sherbimeve te ofruara, pra pikerisht te identifikojne subjektin tregtar ofruer te sherbimeve.

3. Pra vleresuar qe elementi "{...}" eshte elementi dominant, me i rendesishem, qe permban peshen me te madhe te karakterit dallues te markes qe kerkohet te shfuqizohet. Gjithashtu, dy subjektet ne konflikt ofrojne sherbime te se njejtës natyre pra te fushes se barit, restorantit etj, pra jane pjeserisht te njejta dhe pjeserisht shume te ngjashme dhe komplementare te njera-tjetres. Ne keto kushte, dhoma vleresoi se marka e regjistruar eshte teper e ngjashme me emrin tregtar "{...}" te kerkuesit ne kete shqyrtim administrativ, per sherbime te njejta dhe te ngjashme, ne ate mase qe shkakton konfuzion ne publik. Konsumatori i gjendur perballe sherbimeve qe ofrohen me keto dy shenja, rrezikon te konfundohet ne lidhje me ofruerit e ketyre sherbimeve, duke i bashkelidhur ata me njeri tjetrin. Pra jemi ne kushtet e shkronjes "a" te pikes 3 te nenit 143 te ligjit, pasi u vertetua se emri tregtar gezon te drejte te meparshme nga regjistrimi; emri tregtar eshte i ngjashem me marken e regjistruar, dhe qe pronari i emrit tregtar prodhon apo te siguron perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohesh.

Personi i trete {...}:

1 Lidhur me pretendimin e paditesit, ish-mbajtesit te markes tregtare 18149 se emri tregtar i pretenduar nga personi i trete nuk eshte me ne perdorim apo ne treg nga kjo pale, ky kundërshtim nuk mbështetet mbi prova e fakte te verteta. Nga ekstrakti i marre nga QKB verehet se konkurrojnë ne menyre kumulative te dhenat e kerkuesit ne tabelen e ekstraktit duke filluar me: emrin e subjektit {...}, daten e regjistrimit 09.02.2017, adresen e aktivitetit "Toptani Shopping Center", Kati 6, 1001, emri tregtar {...}, telefonin {...}, gjendjen aktiv. Ekstrakti i QKB eshte pasaporta e subjektit tregtar dhe gdo e dhene qe pasqyrohet ne te prezumohet e sakte dhe e vertete. Paditesi qellimisht perpiqet qe nga njera ane te grupoje ne menyre te njeanshme disa te dhena, si data e regjistrimit me emrin e subjektit dhe, nga ana tjetër, perpiqet te ndaje ne menyre te njeanshme disa te dhena te tjera, sig ben me daten dhe emrin tregtar. Qdo e dhene e pasqyruar ne ekstraktin e QKB-se duhet te lexohet ne lidhje te plote me te dhenat e tjera te tabelës. Kjo nenkupton se te gjitha te dhenat duhet te merren ne teresine e tyre dhe jane komplementare ndaj njera-tjetres. Ne asnje moment dhe ne asnje kolone apo rresht te ekstraktit nuk figurojne dy data te ndara per regjistrimin e subjektit dhe per regjistrimin e emrit tregtar te tij. Perkundrazi, data eshte nje e vetme 09.02.2017, e cila eshte data kur eshte regjistruar subjekti kerkues, se bashku me gdo te dhene tjetër qe pasqyrohet ne ekstrakt, perfshire edhe emrin tregtar. Ne konkluzion te kesaj analize, del qarte se emri tregtar "{...}" eshte regjistruar se bashku me subjektin kerkues {...} me 09.02.2017 dhe nga kjo date eshte perdorur ne qarkullimin civil e tregtar edhe motoja "{...}, plot me gjona" qe ka reklamuar veprimtarine tregtare te personit te trete.

2. Fatin e nje emri tregtar, nese do te jete ne perdorim ne treg apo jo, nese kjo prani do te jete e vazhdueshme dhe e pandërprere apo do te realizohet ne menyre periodike sipas nje plani te caktuar biznesi, e vendos vetem pronari i tij. Keshtu, qe nuk mund te vendoset nga nje subjekt tjetër tregtar, sig ne rastin konkret pretendohet nga paditesi, nese emri tregtar i kerkuesit perdoret apo nuk perdoret ne treg. Vete ligji parashikon se deklarimi dhe perzgjedhja e tij varet totalisht ne vullnetin e pronarit te tij, subjektit tregtar perkates dhe jo ne vullnetin e subjekteve te tjera te treg. Theksojme se emri tregtar i subjektit {...} nuk eshte hequr asnjehere nga perdorimi dhe nuk eshte gregjistruar ndonjehere nga QKB-ja, thjesht ka ndryshuar formen e organizimit nga "person fizik" ne "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar". Mbeshtetur ne abstraktin e siperpermendur, jepet edhe nje e dhene qe lidhet me statusin e veprimtarise se subjektit tregtar qe eshte Aktiv, e cila deshmon qarte per sa po argumentojme. Pra, nuk ka ndonje pezullim, apo pasivitet te shprehur ligjerisht nga te dhenat e regjistrimit tregtar. Kerkuesi, si subjekti tregtar me emrin tregtar {...} eshte ne veprimtari aktive, ne perdorim te plote e te pandërprere te emrit te tij tregtar dhe reklamon aktivitetin tregtar ne adresat konkrete qe aktualisht pasqyrohen ne ekstraktin e shoqerise "{...}" sh.p.k. Per sa kohe subjekti tregtar "{...}" nuk eshte gregjistruar nga regjistri tregtar i QKB-se, emri i tij eshte aktiv pavaresisht nje statusi te perkohshem, gjendjes ekonomiko-financiare dhe/ose suksesit te subjektit tregtar qe eshte pronar i ketij emri. Subjekti tregtar mbaron apo shuhet vetem kur zbatohet nje format e njohura ligjerisht nga Kodi Civil, nga legjislacioni tregtar apo nga ligji per falimentimin: me likuidim, vullnetin e pronarit te tij, me bashkim me nje subjekt tjetër, apo me falimentim, por asnjehere per shkak te ndryshimit (uljes) se mases se aktivitetit tregtar apo te gjendjes aktive te tij ne treg.

3. Ne rastin konkret, plotesohen te gjitha kushtet qe konsumatori qe degjon dhe lexon emra tregtare dhe marka te ngjashme te konfundohet dhe te perzgjedhe njerën ne vend te tjetres. Fjala "{...}" e shkruar me germa kapitale eshte rrenja e te dy shenjave tregtare te subjekteve te ndryshme. Prandaj, kjo fjale eshte e mjaftueshme per te shkaktuar ngaterresa ne treg per shkak te ngjashmerise se tyre vizuale dhe degjimore. Shtojca e fjaleve "{...}" ne permbajtjen e markes tregtare eshte totalisht e parendesishme, sepse eshte me germa te vogla dhe ne formen e nje garniture dhe per praktikitet konsumatori ka tendencen te shkurtoje, (per ekonomi kohe), togfjaleshat dhe, tek e fundit mbetet ajo qe terheq me shume vemendjen qe eshte fjala me germa kapitale {...} e njejte ne te dy rastet.

4. Fjala "{...}" ka nje origjinalitet qe terheq vemendjen e konsumatorit dhe zgjedhja ka qene e goditur dhe e bukur. Rendom ne treg gjenden emra te lidhur me te tashmen, ndersa ne rastin konkret eshte nje emertim tregtar qe perfshin traditen ne gatime, si dhe dashurine e gjyshes. Emri "{...}" ka individualitet te larte gjuhësor, eshte terheqes per vemendjen e konsumatorit dhe mbaron kureshtje e emocion. Qdokush eshte u malluar per figuren e dashur te gjyshes dhe gatimet e saj. Prandaj gjasat e ngaterrimit tek dy subjekte te ndryshem qe ofrojne "NONEN" per konsumatorin jane te medha. Ne konkluzion te kesaj analize, emri tregtar "{...}" dhe marka tregtare "{...}... jane shume te ngjashme dhe sjellin e shkaktojne konfuzion per konsumatorin ne treg dhe shkaktojne konkurrence te pandershme per subjektin tregtar te kerkuesit. Per kete arsye, per marken 18149 eshte kerkuar dhe tashme vendosur shfuqizimi i saj, per shkak te konfuzionit qe krijon ne treg tek konsumatorët si rezultat i ngjashmerise se saj me emrin tregtar te subjektit tregtar te z. {...}. Ne vijim te shkaqeve te parashtruara nga paditesi se "...nuk mund te kete emer tregtar pa qene tregtar dhe personi i trete nuk eshte tregtar", shihet se kemi nje ngaterrim te qellimshem konceptit te tregtarit. Subjekti tregtar mund te zgjedhe me vullnetin e tij te lire te organizohet mbi baza individuale si person fizik, ose mbi baza kolektive, si shoqeri tregtare. Sasia e personave, natyra dhe madhesia e strukturese se brendshme organizative te subjektit tregtar nuk kane asnje rendesi per t'i dhene nje subjekti statusin e tregtarit.

5. Mbeshtetur ne te dhenat qe na vijne nga ekstraktet tregtare te marra nga QKB per te dy subjektet dhe nga regjistri i markave tregtare te DPPI-se na rezulton se: a) emri tregtar "{...}" i subjektit tregtar {...} eshte regjistruar ne QKB ne daten 09.02.2017. b) emri tregtar "{...} {...}" i z. {...} eshte regjistruar ne QKB subjekt tregtar me daten 13.03.2017; c) marka tregtare "{...} {...}" e subjektit tregtar te z. Baolli eshte regjistruar me date regjistrimi 06.10.2017 dhe date depozitimi 27.03.2017. Data 9 shkurt 2017 e regjistrimit te emrit tregtar te z. Manushi eshte me perpara ne kohe ne kalendar sesa data 13 mars 2017 e regjistrimit te emrit tregtar "{...} {...}" dhe para dates se regjistrimit te markes tregtare "{...} {...}". Keshtu qe subjekti tregtar i paditesit ka cenuar te drejten e pronesisë mbi emrin tregtar te personit te trete kur ka regjistruar marken tregtare 18149, ndaj eshte kerkuar e vendosur shfuqizimi i kesaj marke me nr. rregjistrim 18149 dhe date 06.10.2017. Marka tregtare nr. 18149 ka ngjashmeri te madhe me emrin tregtar {...} te personit te trete e per rrjedhoje, ka shkelur edhe nje seri dispozitash ligjore qe mbrojne individualitetin e shenjave tregtare te subjekteve te ndryshme tregtare, duke krijuar konfuzion ne treg per konsumatorin dhe konkurrence te pandershme.

•€€€€€€ Vleresimi i gjykates:

Ne lidhje me plotesimin e kushteve formale te padise:

Nje nga kushtet formale te paraqitjes se padise ne gjykimin e mosmarreveshjeve administrative eshte ajo e ezaurimit te rruges administrative te ankimit, si dhe ai i respektimit te afatit te paraqitjes se padise.

Sipas **nenit 129 te ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative ne RSH"**, ligj ky qe ishte ne fuqi ne kohen e nxjerrjes se aktit administrativ, objekt gjykimi "Shterimi i ankimit administrativ, eshte kusht paraprak per ngritjen e padise ne gjykaten kompetente per geshtjet administrative, perveg rasteve kur"

a) *ligji nuk ka parashikuar organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;*

b) *ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar drejtperdrejt ne gjykate;*

c) *organi me i larte ne shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne proceduren administrative.*

Po ashtu, i njejti parashikim ligjor, eshte parashikuar edhe ne ligjin e posagem **nr. 49/2012 "Pergjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"** i ndryshuar, i cili ne **nenin 16 pika 1 te tij**, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykates.

Sipas pikes 2 te nenit 16 te ligjit te siperpermendur, perjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) *ligji nuk parashikon organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;*

b) *ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne gjykate;*

c) *organi me i larte ne shqyrtimin e nje ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne procedimin administrativ.*

Ne lidhje me shterimin ose jo te ankimit administrativ, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin unifikues nr. 1 date 26.11.2010, kane arritur ne perfundimin unifikues sipas te cilit: "Ndjekja e rruges administrative (te apelimit administrativ) per zgjidhjen e mosmarreveshjes administrative perpara se subjekti t i drejtohet gjykates, eshte e detyrueshme vetem nese ligji qe rregullon marredhenien juridike dhe veprimtarine administrative te fushes perkatese, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund te ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek te cilet eventualisht, sipas hierarkise, duhet te drejtohet apelimi administrativ".

Ligji i posagem nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" i ndryshuar, ne nenin 173 pika 7 te tij ka parashikuar se: "Kunder vendimit te marre nga dhoma per shfuqizim/zhvleresim mund te behet ankim, perkundrejt pageses se tarifes perkatese, ne Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data e marrjes se njoftimit te vendimit."

Nga sa shihet, ligji i posagem **nr. 9947, date 07.07.2008 "Perpronesine industriale"** i ndryshuar, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se te shkohet ne gjykate.

Referuar rastit ne gjykim, rezulton ndaj vendimit Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale e cila ka vendosur: "Shfuqizimin e markes me emertim "{...}...{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149, paditesi {...} i eshte drejtuar me ankim administrativ Bordit te Apeliteve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Ky i fundit pasi ka shqyrtuar ankimin administrativ te paraqitur nga paditesi, ne perfundim me vendimin Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 ka vendosur: "Rrezimin e kerkeses per apelimin e aktit Nr. 311/11 date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim."

Nga sa me siper, provohet se pala paditese ka ezauruar rrugen administrative te ankimit, te parashikuar nga neni 173 pika 7 i ligjit **nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale"** i ndryshuar.

Sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 129 te K.Pr.Aministrative, si dhe nenit 16, pika 1, te ligjit nr. 49/2012 *Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative*" i ndryshuar pala paditese legjitimohet per ti u drejtuar gjykates me padi per te kerkuar rivendosjen e se drejtes se tij te pretenduar, si te shkelur apo cenuar nga pala e paditur. Sa me siper, geshtja ne fjale ben pjese ne juridiksionin gjyqesor.

Ne lidhje me afatin e ngritjes se padise:

Ashtu sig u citua me siper, kusht tjetër formal per paraqitjen e padise, eshte ai i respektimit te afatit te paraqitjes se padise.

Ne nenin 18 pika 1 te ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" (Afati per ngritjen e padise) thuhet se:

1. *Padia kunder veprimit administrativ paraqitet ne gjykate brenda 45 diteve.*

Ky afat fillon nga:

a) *data e njoftimit, sipas menyres se percaktuar ne ligj, te aktit administrativ te organit epror, qe ka shqyrtuar ankimin administrativ;*

Ne lidhje me afatet e parashkrimit legjislacioni yne parashikon dy kategori te afateve te parashkrimit; **afate te pergjithshme dhe afate te posagme**, ku afatet e pergjithshme jane me te gjata se afatet e posagme.

Afatet e pergjithshme te parashkrimit zbatohen per te gjitha kerkesat qe i shtrohen parashkrimit shues, kur per keto nuk eshte caktuar ne ligj nje afat i posagem parashkrimi.

Ashtu sig u citua me siper, afati i pergjithshem i ngritjes se padise per te kundershtuar nje akt administrativ, sipas nenit 18, pika 1 te ligjit nr. 49/2012, eshte 45 dite, afat ky qe fillon nga data e njoftimit te aktit.

Ne nenin 184/g te ligjit me **nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale"** i ndryshuar, eshte parashikuar se: "Kunder nje vendimi te Bordit te Apelit mund te behet ankim ne gjykaten kompetente brenda 45 diteve nga dita kur eshte marre njoftim per vendimin."

Nga paditesi pretendohet se ne lidhje me vendimin Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 te Bordit te Apelimit, ka marre dijeni me date 20.01.2020, pretendim ky i cili nuk kundershtua si nga pala e paditur, ashtu dhe personi i trete, ndersa **kerkesepadia eshte depozituar ne gjykate me date 24.02.2020, brenda afatit 45-ditor te parashikuar nga dispozita e sipercituar.**

Sa me siper, gjykata konstaton se padia e paraqitur nga pala paditese ploteson kushtet formale per tu marre ne shqyrtim nga ana e gjykates.

Ne lidhje me legjitimimin e paleve:

Sipas nenit 32/a te K.Pr.Civile, padia mund te ngrihe:

a) *per te kerkuar rivendosjen e nje te drejte ose interesi te ligjshem qe eshte shkelur.*

Interesi i ligjshem gjendet i pasqyruar dhe ne dispozita te tjera procedurale qe rregullojne gjykimin e mosmarreveshjeve administrative.

Keshtu, **sipas nenit 15 te ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"** i ndryshuar, te drejten e ngritjes se padise e ka:

a) *gdo subjekt, qe pretendon se i eshte cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit publik;*

Ne kuptim te ketyre dispozitave procedurale civile, qe te justifikohet ligjerisht kerkimi per njohjen ose rivendosjen e nje te drejte te

shkelur ose te mohuar, kjo duhet te behet vetem prej atij qe i perket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej nje te treti (*legjitimim aktiv*) dhe vetem kundra atij qe me vepren e tij, mohon ose shkel te drejten e kerkuesit (*legjitimim pasiv*).

Nga permbajtja e ketyre dispozitave procedurale del se personi fizik apo juridik mund te kerkojne zgjidhjen e konfliktit administrativ nese plotesohen apo permbushen dy kushte:

Se *pari*; akti administrative duhet te jete i paligjshem.

Se *dyti*; paditesi te jete cenuar ne interesat e tij ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte.

Legjitimiteti i pales ne nje proces gjyqesor nenkupton interesin legjitim dhe te vertete qe duhet te ekzistoje ndermjet pales dhe geshtjes ne shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr. 49/2012, e kondicionon te drejten e paditesit per te ngritur padi me interesin e ligjshem qe duhet te kete ai per njohjen ose rrezimin e nje pretendimi. Interesi i ligjshem lidhet me te drejten e pales per te kerkuar nepermjet gjykates njohjen ose rivendosjen e nje te drejte te mohuar ose te cenuar prej dikujt tjeter.

Referuar rastit ne gjykim, rezulton se me vendimin Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 Dhoma per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka vendosur: "Shfuqizimin e markes me emertim "{...}...{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149, vendim ky i cili eshte lene ne fuqi nga Bordi i Apelimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me vendimin Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 ku eshte vendosur: "Rrezimin e kerkeses per apelimin e aktit Nr. 311/11 date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim."

Sa me siper, ne baze te nenit 32/a dhe 15/a te ligjit nr. 49/2012, paditesi legjitimohet per t'iu drejtuar gjykates per te kundershuar aktet administrative objekt gjykimi, per te kerkuar rivendosjen e se drejtes se tij te pretenduar si te cenuar apo mohuar nga pala e paditur, pasi aktet administrative te sipercituar, kane cenuar te drejten e tij qe rrjedh nga pronesia industriale.

Po ashtu, pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, ka legjitimitet pasiv ne kete gjykim, pasi aktet administrative objekt kundershimi gjyqesor jane nxjerre nga ky organ.

Nga sa me siper, si paditesi ashtu dhe palet e paditura, kane legjitimitet aktiv dhe pasiv ne kete gjykim.

Ne lidhje me themelin e geshtjes:

Ne lidhje me sa u pretendua nga ana e paleve ne kete gjykim, gjykata, referuar rrethanave te faktit, provave te shqyrtuara ne seance gjyqesore si dhe shkakut ligjore te padise, gmon se kerkimet e pales paditese jane te pa bazuara ne ligj dhe ne prova dhe se kerkesepadia e paraqitur prej tij duhet rrezuar, duke arsyetuar si me poshte:

Ashtu sig u citua me siper, paditesi {...} eshte pronar i markes fjale dhe figure me emrin "{...}...{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149, per klasen klases 43 te klasifikimit te Nises, "Sherbime bari; sherbime kafeneje; sherbime kafeterie; sherbime furnizimi ushqimi dhe pijesh, katering; sherbime restoranti; sherbime restoranti me vetesherbim".

Kunder kesaj marke, ne daten 20.12.2018 eshte paraqitur prane Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, nga z.{...} (person i trete ne kete gjykim), kerkesa per shfuqizim, me pretendimin se marka shkel te drejtat e meparshme te emrit te tij tregtar, duke e mbeshtetur pretendimin e tij ne parashikimin e nenit 143 dhe 173 te Ligjit Nr .9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar.

Me vendimin Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 Dhoma per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka vendosur: "Shfuqizimin e markes me emertim "{...}...{...}", regjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale me nr. regj. 18149, vendim ky i cili eshte lene ne fuqi nga Bordi i Apelimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me vendimin Nr. 311/16 Prot., date 22.11.2019 ku eshte vendosur: "Rrezimin e kerkeses per apelimin e aktit Nr. 311/11 date 11.07.2019 te Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim."

Ne piken 1, te nenit 173 te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" i ndryshuar, jane parashikuar rastet e shfuqizimit te nje marke te regjistruar me pare, sipas te cilit:

1. Nje marke e regjistruar mund te shfuqizohet kur:

a) regjistrimi i markes eshte bere ne shkelje te parashikimeve te neneve 142 e 143, te ketij ligji, ne kohen kur eshte depozituar

aplikimi per regjistrim;

b) aplikimi per regjistrimin e markes eshte bere ne keqbesim.

Ne piken 3 te nenit 143 te ligjit ketij ligji eshte perashikuar se: "Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si: a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet."

Referuar dispozites se sipercituar, qe te provohet pretendimi i kerkuesit duhet te plotesohen kushtet kumulative si vijon:

a) Qe kerkuesi mbi shenjen e tij te gezoje te drejta nga nje date me e hershme se sa data e aplikimit te markes qe kerkohet te shfuqizohet.

b) Qe emri tregtar ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te shfuqizohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te shfuqizohet.

Referuar rastit ne gjykim, nga te dhenat e administruara nga ekstrakti i leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, **rezulton se personi i trete {...} eshte regjistruar ne QKB si Person Fizik me NIPT L71409011A, me objekt te ushtrimit te aktivitetit si "Bar Restorant" me emrin tregtar "{...}" me date 09.02.2017.** Ky emer tregtar, rezulton te jete regjistruar qe me regjistrimin e ketij personi si person fizik, dhe nuk rezulton te jete shtuar me vone, pasi nese do te ishte keshtu atehere do te ishte pasqyruar ne ekstraktin historik te ketij subjekti.

Nderkohe, referuar te dhenave te administruara nga ekstrakti i leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit dhe Deshmise se Depozitimit Nr. 311/1 prot, date 29.03.2017, rezulton se mbajtjesi i meparshem i markes objekt gjykimi Z. Altin Vergani (i cili me pas ia ka transferuar kete marke paditesit {...}) rezulton se **eshte regjistruar ne QKB si Person Fizik me NIPT L71513028R, me objekt te ushtrimit te aktivitetit si "Shperndarje taksi e ushqimeve, mengjesore" me emrin tregtar "{...} {...}" me date 13.03.2017, dhe me date 27.03.2017, ka depozituar aplikimin per regjistrimin e markes "{...}...{...}", aplikim ky qe eshte regjistruar prane DPPI me Nr. AL/T/2017/311.**

Pra, rezulton se data e regjistrimit te personit te trete {...} si subjekt tregtar ne QKB, me emer tregtar "{...}" eshte me e hershme sesa data e regjistrimit te paditesit {...} me emer tregtar "{...}...{...}", dhe aplikimit te markes nga ana e ketij te fundit me emertim "{...}...{...}", me nr. regj. 18149, qe eshte data 27.03.2017. Emri "{...}", ne kuptim te VKM nr. 537, date 01.08.2007 "Per rregullat per emrat dhe emertimet tregtare" eshte emertimi tregtar i personit fizik te regjistruar ne regjistrin tregtar prane QKR-se, (sipas kerkeseve te nenit 9, te ligjit nr. 7632, date 4.11.1992), qe perdoret prej tij ne kursin e tregut, i njoftuar vullnetarisht, ne perputhje me shkronjen "a" te pikes 1 te nenit 44 te ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per

regjistrimin e biznesit i ndryshuar. Si i tille, ky emertim ka si qellim identifikimin e origjines se sherbimeve te ofruara, pra pikerisht te identifikojë subjektin tregtar ofrues te sherbimeve.

Ne shenjat ne konflikt, elementet dominante qe permbajne karakterin dallues te tyre jane perkatesisht:

Marka e regjistruar me nr. regj. 18149, verejme se eshte e perbere nga elemente fjale te nderthurura me elemente figurative. Elementi dominant eshte elementi verbal "{...}" per shkak te permasave shume te medha ne krahasim me elementet e tjera, si dhe per shkak te pozicionimit ne teresine e markes. Ne rastin e markave fjale dhe figure, pergjithesisht elementi fjale luan rolin me te rendesishem ne teresine e markes, per arsye te impaktit me te fuqishem qe ka ky element ne ndergjegjen e publikut, per vete forcen qe ka gjuha si mjeti me i plote i komunikimit, duke qene se fjala perceptohet prej konsumatorit nepermjet te parit, te lexuarit, te degjuarit, dhe te folurit (te permendurit verbalisht).

Elementi figurativ i markes qe eshte nje garuzhde, ka karakter dallues te kufizuar pasi eshte (luge) teper i lidhur konceptualisht me llojin e sherbimeve qe ofron marka, pra te restorantit, te shperndarjes se ushqimeve, ofrimit te tyre etj. Eshte tashme praktike tregtare qe luga, piruni, thika etj., jane simbole te njohura te restoranteve p.sh. ne sinjalizimet rrugore per te treguar se ne afersi gjendet nje restorant/bar/vetesherbim ushqimor etj. Gjithashtu, elementi "*di shijet tons*", ka permasa te vogla dhe rezulton ne funksion te elementit kryesor "{...}". Po ashtu, "{...}", eshte kryefjala e fjalise qe perben komponentin verbal te markes se regjistruar dhe elementi "{...}" eshte vendosur ne funksion te plote te kryefjales, pasi tregon dhe informon per cilesi te gjymtyres kryesore te fjalise duke perforcuar karakterin dominues te saj.

Pra elementi "{...}" eshte elementi dominant, me i rendesishem, qe permban peshen me te madhe te karakterit dallues te markes qe kerkohet te shfuqizohet. Gjithashtu, dy subjektet ne konflikt ofrojne sherbime te se njejtës natyre pra te fushes se barit, restorantit etj, pra jane pjeserisht te njejtës dhe pjeserisht shume te ngjashme dhe komplementare te njera-tjetres.

Ne keto kushte, **rezulton se marka e regjistruar eshte teper e ngjashme me emrin tregtar {...} te personit te trete {...}, per sherbime te njejtës dhe te ngjashme, ne ate mase qe shkakton konfuzion ne publik.** Konsumatori i gjendur perballe sherbimeve qe ofrohen me keto dy shenja, rrezikon te konfondohet ne lidhje me ofruesit e ketyre sherbimeve, duke i bashkelidhur ata me njeri tjetrin. Pra jemi ne kushtet e shkronjes "a" te pikes 3 te nenit 143 te ligjit, **pasi u vertetua se emri tregtar gezon te drejte te meparshme nga regjistrimi; emri tregtar eshte i ngjashem me marken e regjistruar, dhe qe pronari i emrit tregtar prodhon apo te siguron perkatesisht mallra ose sherbime, te njejtës ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet**".

Gjykata e vlereson te drejte vendimmarrjen e Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale te shprehur me vendimin Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019, lidhur me kerkesen e personit te trete {...} per te kerkuar deklarimin e pavlefshem te markes tregtare "{...} {...}", te regjistruar nga paditesi per shkak te regjistrimit me pare te emrit tregtar "{...}", sepse ne nenin 143/3/a te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" i ndryshuar, eshte parashikuar se: marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese ajo cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si: **te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbësore e tij te jete e njejtës apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejtës ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet.**

Gjykata vlereson se, sipas legjislacionit ne fuqi mund te mbrohet emri i subjektit tregtar nga prodhimet e ngjashme qe hidhen ne treg subjektet e tjera tregtare, te cilat kane te regjistruara marka tregtare krejt te ngjashme me emrin e nje shoqerie tjetër tregtare.

Sipas ligjit tone, ligjvënësi iu jep nje rendesi te barabarte si mbrojtjes se markes se nje subjekti tregtar nga markat identike ose te ngjashme te subjekteve te tjera tregtare, ashtu edhe emrit tregtar te nje shoqerie nga markat identike, ose te ngjashme te nje shoqerie tjetër. Duhet theksuar se mbrojtja e emrit te shoqerise nga markat identike, ose krejt te ngjashme te nje subjekti tjetër tregtar eshte shume e rendesishme ne fushen e marredhenievet tregtare, sepse nje shoqeri mund te kete disa marka tregtare, ndersa emri i saj eshte i vetem dhe nese cenohet ai prishet imazhi i shoqerise ne teresi, kurse kur cenohet marka demtohet imazhi vetem i nje marke dhe demi qe peson subjekti tregtar ne kete rast eshte me i vogel, pasi nuk cenohen emri dhe markat e tjera tregtare qe i perkasin po kesaj shoqerie.

Duke u bazuar edhe ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*" emri tregtar i nje subjekti konsiston ne nje ose disa fjale qe sherbejne per te identifikuar shoqerine qe kerkon te regjistrohet. Perberja e emrit tregtar eshte e thjeshte, pasi ai nuk mbart ne vetvete edhe elemente te tjere dallues, sig mund te jene logot apo elementet vizual, fonetik, etj, sepse keto te fundit jane vegori vetem e markave tregtare, por ne rastin ne shqyrtim emri tregtar i personit te trete eshte "{...}" dhe marka e regjistruar nga pala paditese eshte "{...} ...*di shijet tons*", prandaj me te drejte me kerkesen drejtuar Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale personi i trete {...}, ka kerkuar mbrojtjen e emrit tregtar te regjistruar me pare nga nje marke e nje subjekti tjetër qe eshte e regjistruar me vone, e cila eshte shume e ngjashme me emrin tregtar te personit te trete, prandaj asnje subjekt i te drejtes tregtare nuk mund te tregtoje mallra ose produkte qe kane emer te ngjashem me emrin e nje shoqerie tjetër, pavaresisht te ekzistences se nje marke tregtare qe eshte regjistruar ne kundërshtim me ligjin.

Lidhur me pretendimin e paditesit se emri tregtar i pretenduar nga personi i trete nuk eshte me ne perdorim ne treg nga kjo pale por nga nje tjetër subjekt juridik, shoqeria "{...}" sh.p.k., e regjistruar ne 04.07.2018, pra shume kohe pas regjistrimit te markes nga ana e paditesit, gjykata gmon se ai **nuk eshte i bazuar, pasi referuar ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, rezulton se administrator dhe ortak i vetem i shoqerise "{...}" sh.p.k eshte personi i trete {...}, i cili i ka transferuar shoqerise se themeluar prej tij edhe emrin tregtar "{...}" (te cilin e disponon qe me regjistrimin si person fizik me date 09.02.2017) veprim ky qe vjen ne perputhje me nenin 5 pika 1 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 *Per tregtaret dhe shoqerite tregtare i ndryshuar, i cili parashikon se: Personi, te cilit i transferohet veprimtaria e nje tregtari ose e nje shoqerie tregtare, mund te vijoje te perdore emrin e regjistruar apo shenjat e tjera dalluese te veprimtarise, me ose pa nje shtese, qe tregon ndermmin e pronesise, nese titullari i meparshem i veprimtarise apo trashegimtaret e tj e miratojne kete perdorim.***

Po ashtu, fakti se ne kohen ne regjistrimit te markes tregtare "{...} {...}", personi fizik {...} (pale e trete ne kete gjykim) figuron ne QKB me *satusin "i pezulluar"* pra qe nuk ushtronte aktivitet tregtar, gjykata, thekson se statusi "*i pezulluar*" apo "*pasiv*" nuk i heq te drejten subjektit qe te gezojete drejten e emrit tregtar, pasi ne gdo moment ai mund ta aktivizoje ate ne "aktiv. Vetem me gregjistrimin ne regjistrin tregtar (QKB) subjekti nuk mund te ushtroje veprimtari tragtare. Pra edhe ne rastin e statusit "*i pezulluar*" ai gezon te drejten e mbrojtjes se emrit tragtar ne baze te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" i ndryshuar.

Sa me siper, gjykata arrin ne perfundimin se akti administrativ Vendimi Nr. 311/11 Prot., date 11.07.2019 i Dhomes per Shfuqizim/Zhvleresim prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale dhe Vendimi nr. 311/16 prot, date 22.11.2019 i Bordit te Apelimit, jane akte administrative te nxjerra ne perputhje me ligjin material nr. 9947, date 07.07.2008 "*Perpronesine industriale*" i ndryshuar.

Perfundimisht, nga sa u analizua me siper, gjykata arrin ne perfundimin se kerkesepadia e paraqitur nga paditesi {...} duhet rrezuar teresisht, si e pa bazuar ne ligj e ne prova.

Per keto arsye

Gjykata, bazuar ne nenet 126, 306 te K.Pr.Civile, si dhe nenin 40/3 te ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative i ndryshuar.

VENDOSI:

Vendosi:

- Rrezimin e padise se paraqitur nga paditesi {...} si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova.
- Shpenzimet gjyqesore lihen ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Administrative te Apelit Tirane duke filluar nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.
- U shpall ne Tirane sot me date 10.07.2020.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}